

VENDIM
Nr. 4, datë 9.1.2025

**PËR MIRATIMIN E VLERAVE PËR SECILIN ELEMENT PËRBËRËS TË
PAGËS BRUTO MUJORE DHE PËRCAKTIMIN E KRITEREVE E TË
PROCEDURAVE PËR DHËNIEN E SHPËRBLIMEVE PËR PUNONJËSIT E
POLICISË SË SHTETIT**

(Ndryshuar me VKM nr. 124, datë 27.2.2026)

(I përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të shkronjës “a”, të pikës 2, të nenit 8, të ligjit nr. 35/2023, “Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike, si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi”, të ndryshuar, dhe të pikave 2, shkronjat “a” e “d”, dhe 4, të nenit 104, të ligjit nr. 82/2024, “Për Policinë e Shtetit”, me propozimin e zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ky vendim ka për qëllim:

a) miratimin e vlerave për secilin element përbërës të pagës bruto mujore të punonjësve të Policisë së Shtetit sipas strukturave në të cilat ushtrojnë funksionet policore;

b) miratimin e trajtimit financiar të:

i. kursantëve që pranohen në kolegjin profesional “Kolegji i Policisë”;

ii. punonjësve të policisë të rolit zbatues dhe shtetasve që kanë përfunduar arsimin e mesëm të lartë, që pranohen të vazhdojnë programet e studimit në Akademinë e Sigurisë me kohë të plotë dhe studentëve që caktohen për të ndjekur studimet me kohë të plotë në akademitë e policisë së shteteve partnere, sipas marrëveshjeve të përbashkëta;

iii. punonjësve të Policisë së Shtetit që kryejnë kurse shkollimi/trajnimi;

iv. punonjësve të Policisë së Shtetit që bashkëpunojnë me institucionet arsimore të sistemit policor, si punonjës të jashtëm;

c) përcaktimin e kriterëve e të procedurave për dhënie e shpërblimeve për rezultate të larta në kryerjen e detyrës.

2. Elementet përbërëse të pagës bruto mujore dhe vlerat për secilin element për punonjësit e Policisë së Shtetit janë, si më poshtë vijon:

a) Paga për gradë, që përfaqëson nivelin e pagës së punonjësit të policisë, në përputhje me gradën që ka fituar. Vlera e pagës për gradë përcaktohet në lidhjen nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij;

b) Shtesa për natyrë të veçantë pune e lidhur me natyrën e veçantë të punës apo të shërbimit, për kohën që punonjësit e policisë ushtrojnë detyrat funksionale (sipas funksioneve/pozicioneve të miratuara në organikë) dhe që përcaktohet:

i. në lidhjen nr. 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij, për punonjësit e policisë që punojnë në strukturat e luftës kundër krimit të organizuar, krimeve të rënda, antiterrorit dhe në strukturat e policisë shkencore;

ii. në lidhjen nr. 3, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij, për punonjësit e policisë që punojnë në strukturat e ruajtjes së rendit dhe sigurisë publike;

iii. në lidhjen nr. 4, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij, për punonjësit e policisë që punojnë në strukturat e policisë kufitare dhe migracionit;

iv. në lidhjen nr. 5, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij, për punonjësit e policisë që punojnë në strukturat e tjera policore;

v. në lidhjen nr. 6, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij, për punonjësit e policisë që punojnë në pozicione që lidhen me procesin e informatizimit të administratës publike dhe kërkojnë, në mënyrë të detyrueshme, diplomë universitare të nivelit “Master i Shkencave”, “Master Profesional”, “Bachelor” apo të barasvlershme me to, sipas legjislacionit të arsimit të lartë, në degët “Inxhinieri elektronike”, “Inxhinieri informatike”, “Informatikë”, “Inxhinieri telekomunikacioni”, “Teknologji informacioni”, “Informatikë ekonomike” “Informatikë biznesi”, “Inxhinieri matematike informatike”, “Shkenca kompjuterike” apo “Inxhinieri matematike (në analiza sistemesh)”;

c) Shtesa për natyrë të veçantë pune, që lidhet me kushte të vështira e të dëmshme për shëndetin, që aplikohet në rastet kur punonjësit e policisë punojnë në vende pune të vështira e të dëmshme për shëndetin. Masa e kësaj shtese përcaktohet në lidhjen nr. 7, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij;

ç) Shtesa për funksionet organike për punonjësit e rolit zbatues përcaktohet në lidhjen nr. 8, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij;

d) Shtesa për vjetërsi në shërbim që është shtesa që përfiton punonjësi i policisë me grada për kohën e qëndrimit në grada aplikohet në masën 1% për çdo vit deri në 25 (njëzet e pesë) vjet. Llogaritja e shtesës për vjetërsi bëhet mbi pagën për gradë të nivelit më të ulët të gradës sipas ndarjes në role.

3. Përjashtimisht, deri në datën 1 janar 2026, shtesa për vjetërsi në shërbim sipas shkronjës “d”, të pikës 2, të këtij vendimi, llogaritet mbi pagën e gradës “inspektor”.

4. Për efekt të llogaritjes së shtesës për vjetërsi në shërbim, vite shërbimi do të konsiderohen vitet e qëndrimit në grada, të dokumentuara në librezën e punës apo, në mungesë të librezës së punës, me çdo dokument tjetër ligjor të lëshuar nga organet kompetente përkatëse, sipas legjislacionit në fuqi, të çdo punonjësi në strukturat e Policisë së Shtetit, Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, Policisë së Burgjeve, Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit, Gardës së Republikës së Shqipërisë, Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, si dhe në strukturat e Shërbimit Informativ të Shtetit.

5. Vitet që përjashtohen nga llogaritja e shtesës së vjetërsisë në shërbim, vetëm për efekt page, janë vitet e sigurimit vullnetar, vetëpunësimit, vitet e punës si punonjës pa gradë, vitet e shërbimit ushtarak për meshkujt, vitet e shkollimit në institucionet e arsimit ushtarak të Ministrisë së Brendshme e të Ministrisë së Mbrojtjes, si dhe periudhat e trajtimit me pagesë papunësie apo pagesë kalimtare.

6. Kursantët që pranohen në Kolegjin Profesional të Formimit Policor, në Akademinë e Sigurisë, gjatë periudhës së shkollimit përfitojnë trajtim financiar, në masën 15 000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë në muaj.

7. Punonjësit e policisë të rolit zbatues dhe shtetasit, që kanë përfunduar arsimin e mesëm të lartë, që pranohen dhe vazhdojnë programet e studimit në Akademinë e Sigurisë me kohë të plotë, për ciklin e parë të studimeve “Bachelor”, si dhe studentët që caktohen për të ndjekur studimet me kohë të plotë në akademitë e policisë të shteteve partnere sipas marrëveshjeve të përbashkëta, gjatë periudhës së shkollimit përfitojnë çdo muaj një bursë shkollimi të barabartë me pagën për gradën “inspektor”.

Këtë trajtim e përfitojnë edhe shtetasit që pranohen në Akademinë e Sigurisë të cilët kanë përfunduar ciklin e dytë të studimeve të arsimit të lartë dhe plotësojnë kriteret e përcaktuara në dispozitat përkatëse në ligjin për Policinë e Shtetit.

8. Punonjësi i policisë, që shkollohet/trajnohet, brenda ose jashtë vendit, në kuadër të programeve të shkollimit/trajnimit, të parashikuara e të organizuara nga institucioni gjatë periudhës së shkollimit/trajnimit, përfiton të njëjtën pagë bruto mujore, që përfitonte përpara fillimit të kursit të shkollimit/trajnimit. Paga e punonjësit të Policisë kryhet nga njësia buxhetore, ku është efektiv punonjësi, përpara fillimit të kursit të shkollimit/trajnimit.

9. Në rastet kur punonjësi i policisë ka fituar një kurs shkollimi apo trajnimi në mënyrë individuale dhe jo me iniciativën e institucionit, gjatë kohës së shkollimit/trajnimit nuk përfiton pagesë nga institucioni.

10. Punonjësi i policisë, që nuk është efektiv me kohë të plotë në institucionet e sistemit arsimor policor, por bashkëpunon me këto institucione si punonjës i jashtëm, për çdo orë mësimore 60-minutëshe, përfiton një pagesë, si më poshtë vijon:

a) Në kurset e formimit bazë për punonjësit me gradë “Inspektor”, në masën 600 (gjashtëqind) lekë/për orë;

b) Në kurset e shkollimit/trajnimit për punonjësit e gradave “Nënkomisar” dhe “Komisar”, në masën 800 (tetëqind) lekë/për orë;

c) Në kurset e shkollimit/trajnimit për punonjësit e gradave “Kryekomisar” deri në “Drejtues i Parë”, në masën 1000 (një mijë) lekë/për orë.

11. Drejtori i përgjithshëm i Policisë së Shtetit shpërblen punonjësit e Policisë së Shtetit për rezultate të larta në kryerjen e detyrës, në përputhje me kriteret e përcaktuara për këtë qëllim. Masa e këtij shpërblimi është deri në 3 (tre) paga mujore në vit.

12. Kriteret për përfitimin e shpërblimit për rezultate të larta në kryerjen e detyrës janë:

a) kryerja e operacioneve të sigurisë së veçantë dhe zgjidhja e situatave të jashtëzakonshme për rendin dhe sigurinë publike;

b) parandalimi i ngjarjeve të rënda kriminale, si: vrasje, akte terroriste, rrëmbim ose mbajtje peng të personit apo shkatërrimit të pronës me pasoja të rënda;

c) kryerja e operacioneve për kapjen e personave në kërkim me rrezikshmëri të lartë apo autorëve të armatosur të veprave penale pas kryerjes së krimit (në kushtet e flagrancës);

ç) zbulimi, hetimi dhe arrestimi/ndalimi i autorëve të ngjarjeve të rënda kriminale, që kanë impakt në publik;

d) kryerja e operacioneve policore të rëndësishme për hetimin dhe arrestimin/ndalimin e autorëve, që kanë kryer apo kapen në kryerje e sipër të veprave penale të krimit të organizuar, korrupsionit, pastrimit të parave dhe krimit ekonomik;

dh) zbulimi, hetimi dhe arrestimi/ndalimi i grupeve të strukturuar kriminale dhe organizatave kriminale;

e) kryerja e operacioneve të ndërhyrjes për shpëtimin e jetës së njerëzve, në kushtet e emergjencave civile;

ë) kontributi i punonjësit të policisë në rritjen e standardeve të punës në fushën e rendit dhe sigurisë publike, dhe në fusha të tjera të veprimtarisë policore, duke arritur rezultate të larta dhe të dallueshme në kryerjen e detyrës në raport me punonjësit e tjerë të strukturës policore, periudhat paraardhëse, objektivat strategjike dhe programet vjetore të Policisë së Shtetit.

13. Titullarët e njësive shpenzuese, drejtorët e drejtorive qendrore, drejtuesit e departamenteve dhe zëvendësdrejtori i përgjithshëm i Policisë së Shtetit, bazuar në rezultatet e larta të arritura në kryerjen e detyrave, sipas kriterëve të përcaktuara në pikën 12, të këtij vendimi, i propozojnë drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Shtetit shpërblimin e punonjësve, shoqëruar për çdo rast me një relacion shpjegues.

14. Masa e shpërblimit jepet me urdhër të drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

15. Të gjithë punonjësit e rolit zbatues, që kanë pasur gradën “Inspektor i parë” dhe “Inspektor i dytë”, të cilët, për shkak të ligjit nr. 82/2024, “Për Policinë e Shtetit”, marrin gradën “Inspektor”, deri në datën 1 janar 2026, do të vijnë të përfitojnë vlerën e pagës për gradë dhe të shtesave për natyrë të veçantë pune, sipas gradës dhe shtesave që kanë pasur deri në hyrjen në fuqi të këtij vendimi.

16. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, përballohen nga buxheti vjetor i miratuar për programin “Policia e Shtetit” dhe fillojnë:

a) për përcaktimet në shkronjat “ç” dhe “d”, të pikës 2, në pikën 6 dhe në pikën 10, të këtij vendimi, nga data 1 janar 2026;

b) për të gjitha parashikimet e tjera të këtij vendimi, nga momenti i hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

17. Vendimi nr. 416, datë 26.6.2024, i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e vlerave për secilën element përbërës të pagës bruto mujore dhe të trajtimeve të tjera financiare për punonjësit e Policisë së Shtetit”, shfuqizohet, me përjashtim të përcaktimeve në pikat 5 dhe 9, që vijojnë të jenë në fuqi deri në datën 31.12.2025.

18. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR

Edi Rama

Lidhja nr. 1

(Ndryshuar me VKM nr. 124, datë 27.2.2026)

Paga për gradë për punonjësit e policisë

Roli i punonjësve sipas gradave	Grada	Paga mujore për gradë
Për punonjësit e rolit madhor	Drejtues Madhor	184,500
	Drejtues i lartë	164,000
Për punonjësit e rolit të mesëm drejtues	Drejtues i parë	138,375
	Drejtues	123,000
Për punonjësit e rolit të parë drejtues	Kryekomisar	107,625
	Komisar	97,375
	Nënkomisar	88,000
Për punonjësit e rolit zbatues	Inspektor	73,500

Lidhja nr. 2

(Ndryshuar me VKM nr. 124, datë 27.2.2026)

Grada	Shtesa për natyrë të veçantë pune apo shërbimi për punonjësit e policisë që punojnë në strukturat e luftës kundër krimit të organizuar, krimeve të rënda, antiterrorit dhe në strukturat e policisë shkencore							
	Në funksione të: - Drejtorisë së Forcës së Posaçme Operacionale; - Drejtorisë së Mbrojtjes së Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë; - Njësisë Operacionale për Mbrojtjen e Dëshmitarëve dhe B.D; - Të Sektorit të Forcës së Posaçme të Operacioneve Speciale dhe Kërkimit, në Drejtorinë Vendore të Policisë Tiranë	Në funksione të: - Sektorit të Hetimit nën Mbulim në Drejtorinë e Forcës së Posaçme Operacionale: (Shef Sektori; Ndhmës specialist për përgjimin ambienta operacion; Njësia e menaxhimit të informatorëve, Seksioni rajonal për menaxhimin e informatorëve)	Në funksione të Drejtorisë së Forcës së Posaçme Operacionale: - Sektori i hetimit në mbulim (specialist, ndihmës specialist)	Në funksione të Drejtorisë së Forcës së Posaçme Operacionale: - Sektori i Forcës së Posaçme Operacionale (Shef njësie/ specialist; Përgjegjës grupi; Ndhmës specialist). - Sektori për kërkimin “FAST ALBANIA” (Specialist kërkimi; Ndhmës specialist).	Në funksione të: - Drejtorisë së Antiterrorit; - Për hetimin e krimeve të rënda në strukturat qendrore e vendore të Policisë së Shtetit	Në funksione të: - Sektorit të Zbatimit të Masave Mbrojtëse; - Sektorit të Ndhmës Ligjore dhe Integritit, në Drejtorinë e Mbrojtjes së Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë	Në funksione të: - Inteligjencës dhe Arkivës Kriminale, në Drejtorinë Vendore të Policisë; - Institutit të Policisë Shkencore	Në funksione: - Për Hetimin e Narkotikëve dhe Trafikeve; - Për Hetimin e Krimit Ekonomik e Financiar; - Për Hetimin e Krimit të Organizuar; - Të Inteligjencës dhe Arkivës Kriminale, në Departamentin e Policisë Kriminale (DPK); - Të Njësisë për mbështetjen Hetimore Ndërkombëtare në DPK; - Të Njësisë për Trajtimin e Informacionit të Klasifikuar në DPK; - Në funksione të Sektorit të Monitorimit Administrativ; - Të Njësisë së Informacionit të Pasagjerit (NIP) në DPK; - Të Policisë Shkencore në strukturat vendore të Policisë së Shtetit; - Për Hetimin e Krimeve Kibernetike në strukturat qendrore e vendore të Policisë së Shtetit; - Për përgjimet ambientale dhe për mbështetjen operacionale të hetimit në DVP; - Sektorit për Përgjimet e Telekomunikacionit në Departamentin e Policisë Kriminale
Inspektor	15,500	25,000	39,000	29,500	11,000	15,000	7,000	9,000
Nënkomisar	15,500	25,000		29,500	11,000	15,000	7,000	9,000
Komisar	15,500	25,000		29,500	11,000	15,000	7,000	9,000
Kryekomisar	15,500	25,000	39,000		11,000	15,000	7,000	9,000
Drejtues	15,500	25,000			11,000	15,000	7,000	9,000
Drejtues i parë	15,500	25,000			11,000	15,000	7,000	9,000

Lidhja nr. 3

(Ndryshuar me VKM nr. 124, datë 27.2.2026)

Grada	Shtesa për natyrë të veçantë pune apo shërbimi për punonjësit e policisë që punojnë në strukturat e ruajtjes së rendit dhe sigurisë publike						
	Në funksione të: - Njësisë speciale “RENEA” (Shef Njësie, zv./ Shef Njësie);	Në funksionet: - Në strukturat e Njësisë Speciale të Mbrojtjes së Veçantë NJSMV	Në funksionet: - Për krimet në volum në strukturat qendrore dhe vendore të	Në funksionet: - Për Rendin Publik në strukturat qendrore e vendore të Policisë së Shtetit; - Policisë Rrugore në strukturat qendrore e vendore të Policisë së Shtetit;	Në funksione: - Të Policimit në komunitet në strukturat qendrore dhe vendore të Policisë së Shtetit (shef sektori e seksioni, specialist i policimit në komunitet, specialist, ndihmës specialist për edukimin në shkollë dhe punën me të rinjtë); - Ndhmës specialist/ SPZ; - Specialist/koordinator për SPZ;	Në funksione të: - Seksionit të Trajnimit në njësitë e sigurive	Në funksione të: - Njësisë të Sigurisë Publike: (shef njësie dhe strukturat operacionale). - Struktura Operacionale (Seksioni i Operacioneve, Seksioni Operacional, Seksioni Operacional Alpin, Seksioni Operacional Dragot)

	- Në strukturat operacionale të Njësive Speciale “RENEA”; - Njësive speciale të negocimit; - Njësive speciale antieksplziv	(Shef njësie, zv. shef njësie, Seksioni operacional për mbrojtjen e personave me cilësi të veçantë); - E seksionit të patrullës së përgjithshme dhe F.P Shqiponja; - Të Forcës së Posaçme “Shqiponja”/ “Shigjeta”	Policisë së Shtetit; - Drejtorisë së Forcave Kombëtare të Sigurisë; - Zv./drejtor në drejtorinë vendore të policisë; - Shefi i Komisarit të policisë; - Shefi stacioni dhe specialist	- Menaxhimit dhe drejtimit në strukturat qendrore dhe vendore të Policisë së Shtetit; - Analizës strategjike, planifikimit, monitorimit dhe vlerësimit; - Analizës së riskut, analizës strategjike, planifikimit monitorimit dhe vlerësimit; - Patrullës së përgjithshme dhe sigurisë; - Të sigurisë dhe shoqërimit, në strukturat vendore të Policisë së Shtetit; - Të rendit publik, në sallat e komandimit, të drejtimit në sektorin/ seksionin e komandës dhe kontrollit; - Ndihmës specialist informacioni, përgjegjës tumi, specialist tumi dhe informacioni; - Sigurimit të objekteve në strukturat vendore; - Informacionit, ruajtjes dhe sigurimit të objekteve; - Njësive të Sigurisë dhe Ceremonialit	- Ndihmës specialist, përgjegjës për dhomat e sigurisë dhe trup shërbimi për ruajtjen e dhomave të sigurisë; - Shefi Poste policie; - Shefi Stacioni policie	publike	
Inspektor	65,000	15,500	9,000	6,000	7,000	11,000	25,000
Nënkomisar	65,000	15,500	9,000	6,000	7,000	11,000	25,000
Komisar	65,000	15,500	9,000	6,000	7,000	11,000	25,000
Kryekomisar	65,000	15,500	9,000	6,000	7,000	11,000	25,000
Drejtues	65,000	15,500	9,000	6,000	7,000	11,000	
Drejtues i parë		15,500	9,000	6,000	7,000	11,000	

Lidhja nr. 4

Grada	Shtesa për natyrë të veçantë pune apo shërbimi për punonjësit e policisë që punojnë në strukturat e policisë kufitare dhe migracionit				
	Në funksione:	Në funksione:	Në funksione:	Në funksione:	Në funksione:
	- Shef njësie në Njësine Speciale për Kufirin dhe Migracionin	- Të kufirit dhe zbatimit të masave plotësuese të kontrollit të	- Drejtor i Drejtorisë Vendore për Kufirin dhe Migracionin; - Drejtor i Qendrës së	- Të kufirit; - Të migracionit; - Të Analizës së Riskut dhe	- Të Institutit të Përgatitjes së Qenve të Policisë.

	“Delta”; - Të shërbimeve operacionale tokësore e detare, të Njësisë Speciale për Kufirin dhe Migracionin “Delta”.	territorit në DVKM Tiranë; - Të hetimit të masave plotësuese për kontrollin e territorit; - Të hetimit dhe zbatimit të masave plotësuese për kontrollin e territorit.	Mbyllur; - Shef Komisariati për Kufirin dhe Migracionin.	Statistikës në strukturat qendrore dhe vendore të policisë; - Në seksionin e pritjes trajtimi dhe sigurisë në QMH; - Stacionet e Policisë Kufitare; - Postat e Policisë Kufitare; - Të sallave të komandës dhe drejtimit; - Të Qendrës Ndërinstitucionale Operacionale Detare; - Të qendrave të shkëmbimit të informacionit; - Të seksionit të sigurisë kufitare.	
Inspektor	15,000	7,000		6,000	6,000
Nënkomisar	15,000	7,000		6,000	6,000
Komisar	15,000	7,000	9,000	6,000	6,000
Kryekomisar	15,000	7,000	9,000	6,000	6,000
Drejtues	15,000	7,000	9,000	6,000	6,000
Drejtues i parë		7,000	9,000		

Lidhja nr. 5

Shtesa për natyrë të veçantë pune apo shërbimi për punonjësit e policisë që punojnë në strukturat e tjera policore							
Grada	Në funksione të:	Në funksione:	Në funksione:	Në funksione:	Në funksione:	Në funksione:	Në funksione të:
	- Drejtorisë së Menaxhimit të Informacionit dhe Mbrojtjes së të Dhënave;	- Mbështetëse dhe administrative të sektorëve dhe seksioneve të	- Drejtor drejtorie në varësi të drejtorit të përgjithshëm të	- Asistent i zv./drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Shtetit;	- Shef sektori për komunikimin me median dhe publikun, në Drejtorinë për	- Të drejtorit të drejtorisë vendore të Policisë;	- Drejtorit të drejtorisë vendore të Policisë Tiranë; - Drejtorit të

	- Drejtorisë së Standardeve Profesionale; - Shef sektori në Aparatin e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe Departamentet e Policisë; - Trupë shërbimi/Dajt DTI; - Drejtorisë së Integrimit dhe Planifikimit Strategjik; - Drejtorisë së Planifikimit dhe Administrimit të Trajnimit Policor; - Në funksione të Akademisë së Sigurisë.	strukturave qendrore, vendore dhe strukturave të veçanta të policisë.	Policisë së Shtetit dhe të drejtorit të departamentit; - Drejtori i Kabinetit të DPPSH.	- Asistent i drejtorit të departamentit; - Asistent në Drejtorinë Vendore të Policisë; - Zëdhënës në Drejtorinë Vendore të Policisë.	Marrëdhëniet me Publikun dhe Median; - Të drejtorive në varësi të Departamentit për Marrëdhëniet Ndërkombëtare.	- Të kabinetit të drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Shtetit (zyra ndihmëse); - Shefit të Sektorit të Auditimit.	departamentit; - Zëvendësdr ejsorit të përgjithshëm të Policisë së Shtetit; - Rektorit të Akademisë së Sigurisë; - Drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Shtetit.
Inspektor	6,000	4,000		7,000	9,000		
Nënkomisar	6,000	4,000		7,000	9,000		
Komisar	6,000	4,000		7,000	9,000		
Kryekomisar	6,000	4,000	15,500	7,000	9,000		
Drejtues	6,000		15,500	7,000	9,000	15,000	
Drejtues i parë	6,000		15,500		9,000	15,000	30,000
Drejtues i lartë							30,000
Drejtues madhor							40,000

Shtesa për natyrë të veçantë pune apo shërbimi për punonjësit e policisë që punojnë në pozicione që lidhen me procesin e informatizimit

1. “Specialistët”, “Përgjegjësit e sektorit”, “Drejtorët e drejtorive” apo “drejtor departamenti”, të cilët punojnë në pozicione që lidhen me procesin e informatizimit të administratës publike dhe kërkojnë, në mënyrë të detyrueshme, diplomë universitare të nivelit “Master i Shkencave/Master Profesional/Bachelor” apo të barasvlershme me to, sipas legjislacionit të arsimit të lartë, në degët “Inxhinieri Elektronike”, “Inxhinieri Informatike”, “Informatikë”, “Inxhinieri Telekomunikacioni”, “Teknologji Informacioni”, “Informatikë Ekonomike” “Informatikë Biznesi”, “Inxhinieri Matematike Informatike”, “Shkenca Kompjuterike”, “Inxhinieri Matematike (në analiza sistemesh)” përfitojnë një shtesë mbi pagë si vijon:

a) Për punonjësit e policisë që punojnë me baza të të dhënave shtetërore, (si punonjësit analogë civilë pa status policor) në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, në nivel qendror, në masën:

60,000 (gjashtëdhjetë mijë) lekë në muaj	Për punonjësit e policisë në pozicionet “Specialist”.
50,000 (pesëdhjetë mijë) lekë në muaj	Për punonjësit e policisë në pozicionet “Përgjegjës sektori”.
70,000 (shtatëdhjetë mijë) lekë në muaj	Për punonjësit e policisë në pozicionet “Drejtor drejtorie” apo “drejtor departamenti”.

b) Për punonjësit e policisë në strukturat e TIK-ut në nivel qendror, që punojnë në pozicione IT, që nuk janë përgjegjëse për zhvillimin apo ndjekjen e mirëmbajtjes së bazave të të dhënave shtetërore të miratuara e të regjistruara si të tilla pranë Autoritetit Rregullator Koordinues të Bazave të të Dhënave Shtetërore, sipas legjislacionit në fuqi (si punonjësit analogë civilë pa status policor) në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, në masën 7 500 (shtatë mijë e pesëqind) lekë në muaj.

2. Zbatimi i shtesave si më sipër për pozicionet konkrete të punës miratohet:

a) Nga titullari i Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit për punonjësit e policisë të përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 1, të kësaj lidhjeje, pas propozimit nga njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, sipas përshkrimit të pozicionit të punës;

b) Nga Departamenti i Administratës Publike, për punonjësit e policisë të përcaktuar në shkronjën “b”, të pikës 1, të kësaj lidhjeje, sipas përshkrimit të pozicionit të punës.

Masa e shtesës për natyrë të veçantë pune për shkak të kushteve të vështira e të dëmshme për shëndetin sipas funksioneve organike

Nr.	Emërtimi i funksionit	Emërtimi i strukturës policore	Masa e shtesës në lekë
I	Në strukturat e Policisë Shkencore	Në Institutin e Policisë Shkencore	
1	Drejtor; Shef sektori; Specialist kriminalist; Ndihmës specialist, laborant kriminalist; Inspektor/ekspert; Inspektor; Ekspert.	- Në Institutin e Policisë Shkencore; - Në sektorin e përpunimit të gjurmëve papilare dhe vendit ngjarjes; - Në sektorin e ekzaminimeve, biologjisë dhe ADN-së; - Në sektorin e ekzaminimeve kimike; - Në sektorin e ekzaminimeve balistike.	12,000
2	Shef sektori; Specialist; Specialist kriminalist; Ndihmës specialist; Laborant kriminalist;	- Në sektorin e kontrollit shkencor të cilësisë; - Në sektorin e gjurmëve të gishtave (daktiloskopia); - Në sektorin e ekzaminimeve grafike dhe dokumenteve; - Në sektorin e administrimit të provave dhe dokumentacionit.	10,600

	Specialist i administrimit të provave; Laborant i administrimit të provave.		
3	Shef sektori; Specialist kriminalist; Inspektor; Ekspert.	- Në sektorin e ekzaminimeve kompjuterike dhe audio-video.	5,300
4	Shef sektori; Shef seksioni; Specialist; Ndihmës specialist laborant; Laborant; Specialist ekspert.	Në Drejtorinë Vendore të Policisë Tiranë: - Në sektorin e policisë shkencore; - Në seksionin për vendngjarjet dhe ekzaminimet; - Në sektorin e kartotekës e administrimit të provave. Në komisaritet e Policisë Tiranë: - Në seksionin për krimet. Në drejtoritë vendore të Policisë: - Në sektorin e policisë shkencore. Në komisaritet e Policisë: - Në seksionin e policisë shkencore; - Në seksionin për krimet; - Në seksionin për krimet e rënda dhe për krimet.	10,600
II		Në strukturat e trajtimit dhe magazinimit të lëndëve narkotike	
1	Specialist për trajtimin e lëndëve narkotike. Ndihmës specialist për magazinën e narkotikeve.	- Në Drejtorinë e Përgjithshme për Krimin e Organizuar dhe Krimet e Rënda; - Në sektorin për hetimin e narkotikëve.	10,600
III		Në strukturat e përgjimit	
1	Shef sektori; Specialist; Oficer i policisë gjyqësore përgjimi SHISH; Oficer i policisë gjyqësore zyra e Prokurorit të Përgjithshëm; Ndihmës specialist për përgjimin ambientat operacional; Ndihmës specialist depërtimi dhe kamuflimi; Ndihmës specialist për hetimin; Ndihmës specialist përgjimi në operacione speciale.	- Në sektorin e përgjimit e telekomunikimit; - Në Drejtorinë e Forcës së Posaçme Operacionale; - Në sektorin e hetimit nën mbulim dhe funksionet në sektorin e mbështetjes tekniko- shkencore; - Në qendrën e drejtimit dhe menaxhimit të operacioneve speciale.	5,300
2	Shef seksioni; Specialist për përgjimin dhe depërtimi; Ndihmës specialist.	Në drejtoritë vendore të Policisë Tiranë: - Në seksionin tekniko-shkencor dhe depërtimin.	5,300
3	Shef seksioni; Specialist; Ndihmës specialist; Specialist për teknologjinë dhe përgjimin; Ndihmës specialist për teknologjinë dhe përgjimin.	Në drejtoritë vendore të Policisë: - Në seksionin e teknologjisë dhe përgjimit; - Në Komisaritet e Policisë.	5,300
IV		Në strukturat e trajtimit të eksplozivëve dhe lëndëve të tjera plasëse:	
1	Shef njësie; Specialist antiexplozivësh në forcat speciale; Ndihmës specialist, në forcat speciale; Shoqërues qeni dhe shofer.	- Në Njësinë Speciale të Antiexplozivëve.	9,300
V		Zhytësit dhe punonjësit e shërbimeve operacionale detare:	
1	Komandant njësie; Zëvendëskomandant njësie; Trupë shërbimi operacional/zhytës; Trupë shërbimi operacional/zhytës dhe shofer; Shef seksioni; Specialist për shërbimet e kufirit blu; Përgjegjës grupi, drejtues mjeti lundrues; Trupë shërbimi, motorist; Trupë shërbimi operator.	- Në njësinë speciale të zhytjes; - Në shërbimet operacionale detare	1,500
VI		Në strukturat e policisë rrugore:	
1	Shef njësie; Specialist; Trupë shërbimi Ndihmës specialist; Specialist për policinë rrugore, koordinator; Shef seksioni; Specialist shërbimi, përgjegjës; Përgjegjës trupë shërbimi. Ndihmës specialist; Oficer i policisë gjyqësore; Specialist; Ekspert.	Në njësinë operacionale për sigurinë rrugore dhe sigurinë e autostradave. Në Drejtorinë Vendore të Policisë Tiranë: - Në Komisaritetin e Policisë Rrugore Tiranë dhe në seksionin e trafikut interurban dhe urban, në strukturat organike të Policisë së Shtetit; - Në Komisaritetin Rajonal të Policisë Rrugore; - Në seksionin e parandalimit dhe sigurisë në trafikun urban; - Në seksionin e parandalimit dhe sigurisë në linja jashtë qytetit; - Në seksionin e verifikimit të shkeljeve administrative dhe analizës; - Në seksionin e hetimit të aksidenteve rrugore (OPGJ); - Në seksionin e verifikimit të aksidenteve rrugore (ekspertët/dëme materiale).	5,300
2	Shef sektori; Shef seksioni; Specialist i hetimit të ngjarjeve në qarkullim; Specialist shërbimi, përgjegjës grupi; Përgjegjës grupi; Trupë shërbimi; Trupë shërbimi trafiku dhe linja në të gjitha strukturat e policisë rrugore.	Në drejtoritë vendore të Policisë: - Në sektorin e policisë rrugore; - Në seksionin e hetimit të ngjarjeve në qarkullim dhe AIS. Në komisaritet e Policisë: - Në seksionin e kontrollit dhe menaxhimit të qarkullimit rrugor.	5,300
VII		Në strukturat e Policisë së Shtetit:	
1	Shef seksioni; Mjek; Trupë operacionale; Ndihmësmjek;	- Në repartin special "RENEA";	4,000

Trupe shërbimi operacional shofer ambulance; Specialist mjek; Ndihmës mjek trupë operationale.	-	Në Njësitë e Ndërhyrjes së Shpejtë.	
--	---	-------------------------------------	--

Lidhja nr. 8

Shtesa për funksionet organike për punonjësit e rolit zbatues

Funksioni organik	Vlera
Në strukturat e vendore: - Ndihmës specialist për informacionin; - Ndihmës specialist përgjegjës për dhomat e sigurisë; - Ndihmës specialist për komandën dhe koordinimin; - Ndihmës specialist për policimin në komunitet, SPZ; - Ndihmës specialist, Seksioni për shërbimin ndaj të tretëve; - Ndihmës specialist për komandën dhe koordinimin; - Ndihmës specialist SPZ; - Ndihmës specialist për zbatimin e vendimeve penale dhe kontrollin e armëve; - Ndihmës specialist për edukimin në shkolla dhe punën me të rinjtë; - Ndihmës specialist operator, për shërbimin ndaj të tretëve; - Ndihmës specialist i komandës dhe kontrollit. Në strukturat e DVKM-së: - Ndihmës specialist për analizën e riskut e statistikën; - Komandant Skuadre; - Ndihmës specialist, Seksioni i Hetimit dhe Zbatimit të Masave Plotësuese për Kontrollin e Territorit; - Ndihmës specialist informacioni, në Komisaratin e Policisë Kufitare Sarandë; - Përgjegjës grupi, drejtues mjeti lundrues; - Ndihmës specialist, intervist, për riintegrimin, ripranimin/kontrollor; - Ndihmës specialist, Qendra e Shkëmbimit të Informacionit me Greqinë; - Ndihmës specialist, Qendra e Shkëmbimit të Informacionit me Kosovën; - Ndihmës specialist, Qendra e Shkëmbimit të Informacionit me Maqedoninë. Në strukturat qendrore: - Ndihmës specialist hetimi, Sektori për Përgjimet e Telekomunikacionit; - Ndihmës specialist për arkivimin, Njësia për Trajtimin të Informacionit të klasifikuar; - Ndihmës specialist, Njësia për Administrimin e Provave Materiale; - Ndihmës specialist, turni dhe informacioni, në Njësinë e Sigurisë dhe Ceremonialit; - Ndihmës specialist për përgatitjen, në Institutin e Përgatitjes së Qenve të Policisë; - Ndihmës specialist , në DFPO; - Ndihmës specialist për përgjimin ambienta operacionale, në DFPO; - Ndihmës specialist depërtimi dhe kamuflimi, në DFPO; - Përgjegjës grupi, drejtues mjeti lundrues, Njësia Speciale për Kufirin "DELTA".	10 000 (dhjetëmijë) lekë
Funksioni Organik	Vlera
Në strukturat vendore: - Ndihmës specialist për analizën dhe statistikën; - Ndihmës specialist, Seksioni i arkivit kriminal; - Ndihmës specialist për arkivin kriminal; - Ndihmës specialist, Seksioni i informacionit policor; - Ndihmës specialist për informacionin policor dhe statistikën;	5 000 (pesëmijë) lekë

- Ndihmës specialist për informacionin policor dhe arkivin kriminale; - Ndihmës specialist për operacionet policore; - Ndihmës specialist për marrjen/analizimin e pamjeve filmike; - Ndihmës specialist për kërkimin; - Ndihmës specialist, Seksioni për mbështetjen tekniko shkencore dhe depërtimin; - Ndihmës specialist laborant, Seksioni i kartotekës dhe administrimit të provave; - Ndihmës specialist për sigurinë, Seksioni i patrullës së përgjithshme dhe sigurisë; - Ndihmës specialist për sigurinë dhe informacionin; - Trupë shërbimi për ruajtjen e dhomave të sigurisë; - Ndihmës specialist për shoqërimin dhe sigurinë; - Ndihmës specialist për administrimin e dokumenteve; - Ndihmës specialist, kujdestar ai dhe komandant nëngrupi; - Ndihmës specialist laborant për Policinë Shkencore; - Laborant për Policinë Shkencore, Seksioni i hetimit të aksidenteve Rrugore (Shërbimi i policisë gjyqësore), Komisariati i Policisë Rrugore Tiranë; - Ndihmës specialist, Seksioni i Sallës së Komandimit, Komisariati i Policisë Rrugore Tiranë; - Ndihmës specialist për Krimet; - Ndihmës specialist, ruajtje dhe sigurim i objekteve; - Ndihmës specialist, Seksioni i vendit të ngjarjes dhe ekzaminimeve; - Ndihmës specialist, Seksioni i Kartotekës dhe Administrimit të Provave; - Ndihmës specialist, Seksioni për Hetimin e Krimeve Kibernetike; - Ndihmës specialist përgjimi; - Ndihmës specialist, Seksioni për Mbështetjen Operacionale të Hetimit; - Ndihmës specialist, Seksioni i Administrimit të Dokumentove dhe AIS; - Ndihmës specialist sigurim objekti dhe informacioni; - Trup shërbimi operacionale (F.P) Shqiponja/ Motorist, në DVP Fier; - Ndihmës specialist, Seksioni i Monitorimit dhe Koordinimit kundër Kultivimit; - Ndihmës specialist, Seksioni për Hetimin e Narkotikëve; - Ndihmës specialist për Inteligjencën dhe Statistikën; - Ndihmës specialist, Seksioni për Hetimin e Krimeve të Rënda; - Ndihmës specialist, Seksioni i Policisë Shkencore; - Ndihmës specialist (F.P.); - Ndihmës specialist, Seksioni për kontrollin e kontejnerëve; - Ndihmës specialist, Seksioni Për Hetimin e Krimeve ndaj personit. Ne strukturat e DVKM: - Ndihmës specialist i kartotekës dhe arkivit; - Ndihmës specialist, kontrollor; - Ndihmës specialist informacioni, në DVKM Tiranë; - Përgjegjës grupi operacional; - Trupë shërbimi operacional; - Ndihmës specialist, Seksioni për të huajt; - Ndihmës specialist operator për migracionin; - Ndihmës specialist, kontrollor laborant kriminalist; - Ndihmës specialist i vijës së dytë ai dhe kontrollor; - Ndihmës specialist/operator për Sistemin dhe Kamerat/Trup Shërbimi, Kontrollor; - Trupë shërbimi, operator radari. Ne strukturat qendrore:	5 000 (pesë mijë) lekë
---	---------------------------------------

- Ndhmës specialist operator; - Ndhmës specialist, Sektori i Analizës së Informacionit; - Ndhmës specialist/statistikën, Sektori i Analizës Riskut dhe Statistikës, në DPKM; - Ndhmës specialist; - Ndhmës specialist operator (24/7 Europol & Interpol); - Ndhmës specialist për arkivin; - Trupë shërbimi, ruajtje objekti, si komand. skuadre, në Njësinë e Sigurisë dhe Ceremonialit; - Trupë shërbimi ceremoniali si Komandant skuadre, në Njësinë e Sigurisë dhe Ceremonialit; - Ndhmës specialist, operator për kamerat, në Qendrën e Mbyllur të të Huajve.	
--	--